



Pranuar / Doretuar Punëjeto/Prudato Received/Delivered	05.08.2022	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHËRBIMI	4572/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.567/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.567/2022 të datës 24.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër organit të punësimit Ministria e Ekonomisë, në çështjen juridike „kontestim konkursi“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.08.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.567/2022 e datës 24.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ministria e Ekonomisë duke u bazuar në dispozitat e nenit 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 19.04.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 05.05.2022 ka shpallur konkursin RN00008764 për lëvizje brenda kategorisë lidhur me pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm”, për klasën e pozitës Drejtues i ulët 1.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë fillimisht me datën 18.05.2022 ka nxjerrë Njoftimin Nr.Prot.1122, sipas të cilit ankuesin e ka përfshirë në listën e shkurtër, ndërsa me datën 22.06.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.1440, sipas të cilit ankuesi është njoftuar se nuk është përfshirë në listën e ngushtë, në konkursin për lëvizje brenda kategorisë për pozitën

“Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike”. Po me datën 22.06.2022, Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.1448, sipas të cilit e ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm” .

Ankuesi [redacted] i punësuar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, sipas plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës 01.09.2017, në pozitën “Zyrtar certifikues”, kundër Vendimit Nr.Prot.1448 të datës 22.06.2022 për anulimin e procedurës e rekrutimit-ngritje në detyrë për pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm” nga ana e zëvendës Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Ekonomisë, me datën 24.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3701/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 05.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë. Ndërsa me datën 12.07.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4036/2022 nga Ministria e Ekonomisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit të datës 24.06.2022 me numër protokollit 3701/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 19.04.2022; Kopjen e konkursit të datës 05.05.2022 për pozitën Udhëheqës i divizionit të auditimit të Brendshëm; E-mailin zyrtar të datës 18.05.2022; Njoftimin e datës 18.05.2022 përmes e-mailit zyrtar; E-mailin zyrtar të datës 10.06.2022 lidhur me kërkesën për opinion ligjor; E-mailin zyrtar të datës 09.06.2022; E-mailin zyrtar të datës 08.06.2022 lidhur me kërkesën për opinion ligjor; E-mailin zyrtar të datës 06.06.2022 lidhur me kërkesën për opinion ligjor; E-mailin zyrtar të datës 31.05.2022 lidhur me kërkesën për opinion ligjor; Kërkesën e datës 31.05.2022 përmes e-mailit zyrtar; Kërkesën e datës 24.05.2022 përmes e-mailit zyrtar; E-mailin zyrtar të datës 08.06.2022 lidhur me kërkesën për opinion ligjor; E-mailin zyrtar të datës 06.06.2022 lidhur me kërkesën për opinion ligjor; Njoftimin e datës 22.06.2022 përmes e-mailit zyrtar lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit; Njoftimin e datës 18.05.2022 përmes e-mailit zyrtar lidhur me aplikimin e ankuesit; Shkresën zyrtare me numër 1450 të datës 22.06.2022 lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit Udhëheqës i divizionit të auditimit të brendshëm; Vendimin 1440 të datës 22.06.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit; Vendimin 1448 të datës 22.06.2022 lidhur me anulimin e procedurës se rekrutimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.07.2022 nga Ministria e Ekonomisë lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Shkresën zyrtare lidhur me listën mbi emrat e kandidatëve aplikues; Vendimin 789 të datës 05.04.2022 lidhur me miratimin e fillimit te procedurës; Vendimin 1118 të datës 18.05.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit për kandidaten L.O; Vendimin 1119 të datës 18.05.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit për kandidatin S.B; Vendimin 1121 të datës 18.05.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit për kandidaten A.L.L; Vendimin 1120 të datës 18.05.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit për kandidaten B.B; Vendimin 1122 te datës 18.05.2022 lidhur me njoftimin mbi kandidatet në listën e ngushtë; Vendimin 1256 të datës 30.05.2022 lidhur me themelimin e komisionit të vlerësimit; Sqarimin e datës 22.03.2022 përmes

e-mailit zyrtar; Kërkesën e datës 15.03.2022 lidhur me kërkesën për opinion përmes e-mailit zyrtar; Vendimin 01/492 të datës 27.11.2020 nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve; Listën e datës 20.02.2017 lidhur me shoqatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit; E-mailin zyrtar të datës 25.05.2022 lidhur me kërkesën nga Ministria e Ekonomisë; E-mailat zyrtar të datës 25.05.2022; E-mailat zyrtar të datës 24.05.2022; Njoftimin me numër 1248 të datës 27.05.2022 lidhur me përfundimin e verifikimit paraprak të kandidatëve; Njoftimin me numër 1441 të datës 22.06.2022 lidhur me përfundimin e verifikimit paraprak të kandidatëve; Njoftimin me numër 11122 të datës 18.05.2022 lidhur me plotësimin e kushteve të konkursit nga kandidatët aplikues; Shkresën zyrtare lidhur me listën e aplikantëve konkurrues; E-mailin zyrtar të datës 24.05.2022 lidhur me shpalljen e konkursit; Aplikacionin e datës 12.05.2022 të kandidatës [redacted] së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale; Aplikacionin e datës 11.05.2022 të ankuesit së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale; Aplikacionin e datës 12.05.2022 të kandidatës [redacted] së bashku me dëshminë mbi përvojën e punës dhe atë profesionale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është palejuar, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur se konstaton së në Vendimin me Nr.Prot.1440 të datës 22.06.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit për ankuesin, të njëjtit me këtë vendim i'u është dhënë e drejta për ankesë brenda 30 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk ka sjellë asnjë dëshmi që ka parashtruar ankesë tek Njësia Përgjegjëse kundër Vendimit me Nr.Prot.1440 të datës 22.06.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit dhe si rrjedhojë bazuar në këtë ankuesi nuk ka vepruar sipas nenit 15 paragrafit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet me shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj".*

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi përkatës siç parashihet me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet",* si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtrojë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankimit, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"*, po ashtu ndërlidhur me ankesën e ankuesit Kolegji ka gjetur se meqenëse ankuesi në Këshill e ka parashtruar ankesën kundër Vendimit Nr.Prot.1448 të datës 22.06.2022 për anulimin e procedurës së konkursit, i njëjti nuk ka pasur të drejtë të atakoj këtë vendim, ngase nuk është përfshirë në listën e ngushtë si kandidat pjesëmarrës në këtë procedurë dhe në këtë kuptim, Kolegji ka konstatuar se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim edhe me nenin 125 paragrafin 1 dhe nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**.Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda,A.nr.567/2022, datë 05/08/2022

Ardita Perguku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Zëvendës Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

